



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/03 prill 2017) si dhe nenit 4, paragrafi 3, nenit 76, paragrafi 6, dhe nenit 77, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2025, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM TË SIGURUESVE**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për Kontrolllet e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Siguruesve, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 28 prill 2016 (më tutje: rregullorja bazë).

### **Neni 2**

1. Paragrafi 12 i nenit 9 të rregullores bazë plotësohet nga aspekti teknik me pikën a si në vijim:
  - a. Anëtarët e njësisë së auditimit të brendshëm duhet të përmbushin kërkesat siç janë përshkruar në vazhdim:
    - 1.1. Paragrafi 12 i nenit 9 të rregullores bazë, pas nënparagrafit iii të pikës a, plotësohet dhe ndryshohet me pikën b si në vijim:
      - b. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet:
        - i. të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 8 të Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm;
        - ii. Të jetë i certifikuar në fushën e auditimit nga ndonjë:
          - 1.1.1. institucion i akredituar në Kosovë për këtë qëllim;
          - 1.1.2. institucion i mirënjohur ndërkombëtar; apo

- 1.1.3. institucion relevant i akredituar për këtë qëllim nga organi kompetent në vendin në të cilin është themeluar për ofrimin e shërbimeve të certifikimit në fushën e auditimit.
- iii. të jetë individ me reputacion të lartë etik dhe profesional dhe me një përvojë adekuate në fushën e sigurimeve dhe të auditimit.

### **Neni 3**

#### **Dispozitat kalimtare**

Siguruesit duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj Rregulloreje brenda afatit prej 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

### **Neni 4**

#### **Efektet dhe hyrja në fuqi**

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë mbesin në fuqi, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë Rregullore të cilat kanë efekt nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
2. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e rregullores bazë.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi me datë 1 mars 2025.

Dr.sc. Bashkim Nurboja  
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës